

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburant lëndë djegëse naftë” *(për impiantet e ngrohjes kaldaja)*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09134000-7 – Naftë

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 495 200 *(tre milion e katerqind e nentëdhjete e pese mijë e dyqind) Lek pa TVSH;* ose **4 194 240** *(katër milion e njëqind e nentëdhjet e kater mijë e dyqind e dyzet) Leke me-TVSH,* vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me objekt: **“Blerje karburant lëndë djegëse naftë”, për impiantet e ngrohjes kaldaja.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e **Konvikteve të Shkollave të Mesme Bashkia Tiranë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:
Shtojca 7

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçencë per tregtim karburantesh të llojit III/A (Gazoil Diesel 10 ppm) leshuar nga QKL (Qendra Kombëtare e Licensimit) ose Autorizim apo Licensë për tregtim karburantesh (Gazoil Diesel 10 ppm) për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqenëse objekti i prokurimit është blerja e karburantit të llojit: Gazoil Diesel 10 ppm e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve duhet të jenë të rregjistruar në një nga rregjistrat profesionale për zbatimin e objektit të kontratës.

Gjithashtu në nenin 4 të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar përcaktohet se:

" Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë operatorët ekonomikë ofertues që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e tregtimit të karguranteve janë të detyruar që ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë të rregjistruar në rregjistrat përkatës.

Lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik ofertues ju referuam VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, ku në pikën I/2/a dhe në pikën II/1 përcaktohet se:

”I. PROCEDURA E DHËNIES SË LICEN-CAVE TË TREGTIMIT ME SHUMICË TË NAFTËS BRUTO DHE NËNPRODUKTEVE TË SAJ

1. Veprimtaria e tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj bëhet vetëm nga shoqëritë tregtare, të themeluara në formën e shoqërive aksionare, pasi të jenë pajisur me “Licencë tregtimi” nga Qendra Kombëtare e Licencimit (OKL).

2. Licenca “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse”, me kodin VIII.1.A, përfshin tri llojet e veprimtarive, si më poshtë vijon:

a) Lloji “A”: tregtimi me shumicë i naftës bruto e nënprodukteve të saj të kategorive 0, II, III, IV e V, me përjashtim të nënprodukteve që destinohen për furnizimin e mjeteve të fluturimit ajror;

II. PROCEDURA PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR TREGTIMIN ME PAKICË TË KARBURANTEVE, GAZIT TË LËNG-SHËM TË NAFTËS, PËR AUTOMJETET, VAJRAVE LUBRIFIKANTE DHE LËNDËVE DJEGËSE PËR PËRDORIM NGA KON-SUMATORËT FUNDORË

1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

a) Ministri që mbulon veprimtarinë e transportit rrugor, kur stacioni i karburanteve do të ndërtohet në autostradë;

b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.”.

Lidhur me llojin dhe emërtimin e licensës që duhet të zotërojnë operatorët ekonomik ofertues ju referuam VKM nr. 538, datë 26.5.2009 ”Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (OKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, ku në pikën 2 dhe në Aneksin 1 përcaktohet se:

”2. Në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi përcaktohen, rast për rast, të gjitha kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave që trajtohen, si rregull, nga ose nëpërmjet OKL-së. Për secilën prej tyre përcaktohen:

a) Baza ligjore e posaçme sektoriale;

- b) Ndarja në nënkategori, nëse është rasti;
- c) Klasifikime specifike dhe/ose specializime, e standardizuara, nëse është rasti;
- ç) Afatet e vlefshmërisë së licencave;
- d) Rastet e veçanta të nënkategorive të këtyre kategorive që trajtohen pa përfshirjen e QKL-së;
- dh) Rastet e trajtimit nga ose nëpërmjet QKL-së dhe grupin përkatës procedural I, II, III;
- e) Në rastin e trajtimit sipas grupit III “i institucioni tjetër”, që përfshihet në trajtimin e kërkesës për licencë, mënyra e vlerësimit të kërkesës dhe e vendimmarrjes së tij, si dhe afati i kësaj vendimmarrjeje nga dita që QKL-ja ka miratuar kërkesën sipas fazës së parë të shqyrtimit;
- ë) Kriteret e posaçme të licencimit, llojet e faktorëve të veprimtarisë, specifikat apo specialitete mbi të cilat zbatohen këto kritere, si dhe llojet e dokumenteve që përdoren për të provuar plotësimin e këtyre kritereve;
- f) Datën në të cilën licencimi i kategorisë/nënkategorisë përkatëse fillon sipas këtij vendimi;
- g) Rregullime të tjera specifike sipas rastit.

Aneksi I

FUSHA VIII

INDUSTRI DHE SHËRBIME TË TJERA

KATEGORIA VIII.1

PRODHIMI, DEPOZITIMI, TRANSPORTI, PËRDORIMI DHE/OSE TREGETIMI I

PRODUKTEVE DHE/OSE LENDEVE A PAJISJEVE TË TJERA ME RREZIKSHMËRI

1. *Veprimtaritë e “Prodhimit, depozitimit, transportit, përdorimit dhe/ose tregimit të produkteve dhe/ose lëndëve a pajisjeve të tjera me rrezikshmëri” bëjnë pjesë në kategorinë VIII.1 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”..*
2. *Kategoria e këtyre veprimtarive ndahet në tre nënkategori si vijon:*
 - a) *“Tregtimi me shumice i naftes, gazit, nenprodukteve perfs hire ato bio si dhe lendet djegese” me kodin VIII.1.A*
 - b) *“Veprimtari të lidhura me substancat dhe preparatet kimike me rrezikshmeri” me kodin VIII.1.B*
 - c) *“Veprimtari të lidhura me burime me rrezatim jonizues” me kodin VIII.1.C*
3. *Tregtia me pakicë licencohet sipas legjislacionit në fuqi. Veprimtari të tjera specifike me këto lëndë nuk licencohen.*
4. *Kriteret e posaçme të licencimit si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për nënkategorinë VIII.1.A jepen në tabelën 1 më poshtë.*

Tabela 1

Nisur nga sa përcaktohet më sipër, gjykojmë se operatorët ekonomik ofertues të cilët tregtojnë karburante të llojit: Gazoil Diesel 10 ppm, duhet që të jenë të pajisur me licensë

për tregtim me shumicë të llojit III/A ose me licensë apo autorizim të tregtimit pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/a "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose;"

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 të VKM nr. 285, datë 119.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohej që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me licensa profesionale për furnizimin e mallrave objekt prokurimi. Në rastin konkret meqënëse edhe ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar uk lejon që të ushtrohet aktiviteti i tregtimit të karburanteve pa licensë profesionale atëherë njësisia e prokurimit vendosi hartimin dhe vendosjen e këtij kriteri kualifikues.

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratës së xhiros vjetore për 3 (tre) vitet financiare (2020, 2021, 2022) të lëshuar nga organet tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën në njërin nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë jo më pak se **1 380 604** (një milion e treqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e katër) lek.

Sqarim:

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale prej jo më pak se 1 380 604 (një milion treqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e katër)lek në të paktën një vit të periudhës financiare të cituar më sipër 2020, 2021, 2022.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro në fushën e tregëtimit dhe shpërndarjes së karburanteve, prandaj njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 ”Kërkesat për kapacitetet ekonomik-financiare” dhe neni 11, pika 1 ”Kufijtë monetarë” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

” Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomik-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

Neni 11

Kufijtë monetarë

Në përputhje me nenin 33, të LPP-së, kufijtë monetarë janë:

a) Kufiri i lartë monetar:

- 650 000 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;

- 40 000 000 (dyzet milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

b) Kufiri i ulët monetar:

- 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;

- 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

Të njëjtët kufij monetarë zbatohen edhe për kontratat sektoriale”.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit ju referua përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime” ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në tetor të vitit 2023 dhe tatimpaguesit kanë patur afat deri më 31 mars 2023 të dekalronin xhiron e realizuar në vitin 2022 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2020, 2021 dhe 2022.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse fondi limit i procedurës së prokurimit është me vlerë 3 495 200 leke dhe meqënëse kjo vlerë e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar nisur nga përcaktimet e nenit 43, pika 2/c dhe nenit 11 të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 39.5 % e vlerës së fondit limit dhe konkretisht 1 380 604 (një milion e treqind e tetëdhjet mijë e gjashtëqind e katër) lek.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik për të provuar përvojën e mëparshme duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, ku vlera pa TVSH e një ose disa kontratave të jetë **jo më pak se 681 564 (gjashtëqind e tetëdhjet e një mijë e pesëqind gjashtëdhjet**

e katër) lekë. Këto përvoja të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Në rastin kur përvoja e mëparshme e ngjashme është realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara..

b. Në rastin kur përvoja e mëparshme e ngjashme është realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës."

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka përvojën e mëparshme për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar furnizime të ngjashme në fushën e tregëtimit të karburanteve, prandaj njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 4 "Kërkesa të veçanta për kontratat e

mallrave”, nenit 55, pika 4/b ”Procedurë e hapur e thjeshtuar” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

” Neni 40

Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.;

Neni 55

Procedurë e hapur e thjeshtuar

b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”.

Lidhur me vitet për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar furnizimi/et e ngjashme të mëparshme, nisur nga interpretimi i dispozitës së mësipërme njësisia e prokurimit ka përcaktuar si periudhë kohore 3 (tre) vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit si kurse përcaktohet në nenin 40 pika 4, te VKM nr. 285, datë 15.06.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Lidhur me përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik njësisia e prokurimit mbështetur në përcaktimet e mësipërme ligjore ka përcaktuar që operatorët ekonomik ofertues në rastin e furnizimeve të ngjashme të realizuara me sektorin publik, të paraqesin vërtetimeve të lëshuara nga entet publike lidhur me realizimin me sukses të furnizimit me karburant, por nga ana tjetër ka lënë të hapur mundësinë që ofertuesit të paraqesin edhe faturën osë faturat tatimor të shitjes që u përkasin këtyre vërtetimeve.

Lidhur me vlerën e furnizimeve të mëparshme të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është e llojit ”Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” nisur nga përcaktimet e nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se në rastin e procedurave te prokurimit të llojit ”Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, si vlerë për hartimin e kriterit përvojës së mëparshme o të merret për bazë vlera e jo më shumë se 20% e fondit limit dhe u përcaktua që vlera e furnizimeve të ngjashme të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit të jetë jo më shumë se 19.5 % e vlerës së fondit

limit dhe konkretisht jo më pak se vlera 681 564 (gjashtëqind e tetëdhjet e një mijë e pesëqind gjashtëdhjet e katër) lekë.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 9001-2015** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës."

Në nenin 79, pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit."

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 4 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës."

Nisur nga sa parashtruam më sipër kjo kërkesë është e parashikuar në nenin 77 dhe pika 1 të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në të cilin parashikohet se parashikimet për kërkesat e cilësisë i referohen dhe kualifikimeve të ofertuesit. Në rastin konkret nisur nga fakti që procedura e prokurimit është e llojit mallra ju referuam dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar nga ku konstatojmë se në pikën 8 të kësaj dispozite është parashikuar që autoritetet kontraktore në rastin e kësaj procedure prokurimi mund të përcaktojë dhe kritere të tjera për kualifikim dhe që në rastin konkret meqënëse pjesa më e madhe e produktit objekt prokurimi do të përdoret për furnizimin e kaldajave me qëllim ngrohjen e konvikteve ku strehohen nxënësit përcaktoi që ofruesit të disponojnë certifikaten e cilësisë ISO 9001-2015 ose ekuivalente pasi kjo certifikate siguron autoritetin kontraktor se ofertuesit i respekton sistemet e menaxhimit të cilësisë lidhur me tregtimin dhe furnizimin e produktit objekt prokurimi, pra kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu referuar përcaktimeve të nenit 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" është përcaktuar që kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organizëm i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, ku në rastin konkret organizëm kombëtar i akreditimit referuar përcaktimeve të ligjit nr.116, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë" është Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 14001-2015** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 79, pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 4 ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

Nisur nga sa parashtruam më sipër kjo kërkesë është e parashikuar në nenin 77 dhe pika 1 të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik”, në të cilin parashikohet se parashikimet për kërkesat e cilësisë i referohen dhe kualifikimeve të ofertuesit. Në rastin konkret nisur nga fakti që procedura e prokurimit është e llojit mallra ju referuam dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.06.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar nga ku konstatoam se në pikën 8 të kësaj dispozite është parashikuar që autoritetet kontraktore në rastin e kësaj procedure prokurimi mund të përcaktojë dhe kritere të tjera për kualifikim dhe që në rastin konkret meqënëse pjesa më e madhe e produktit objekt prokurimi do të përdoret për furnizimin e kaldajave me qëllim ngrohjen e

konvikteve ku strehohen nxënësit përcaktoi që ofruesit të disponojnë certifikatën e cilësisë ISO 14001-2015 ose ekuivalente pasi kjo certifikatë siguron autoritetin kontraktor se ofertuesit i respekton sistemet e menaxhimit të mjedisit lidhur me tregtimin dhe furnizimin e produktit objekt prokurimi, pra kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit, pasi meqënëse një nga proceset e këtij prokurimi është furnizimi i kaldajave të konvikteve me karburant duke e sjellë produktin me autobot dhe që procesi i furnizimit të kaldajës është një proces i cili kërkon masa sigurie me qëllim që të mos ketë asnjë difekt gjatë këtij procesi, i cili mund të çojë dhe në ndotje mjedisore.

Gjithashtu referuar përcaktimeve të nenit 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" është përcaktuar që kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organizëm i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, ku në rastin konkret organizëm kombëtar i akreditimit referuar përcaktimeve të ligjit nr.116, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë" është Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standardeve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për vitin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës."

Në nenin 79, pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 7/c dhe 8 ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

Gjithashtu në nenin 23 ”Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre”, pika 2/a/v, të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar përcaktohet se:

” 2. a) Inspektorati shtetëror përgjegjës ka të drejtë dhe përgjigjet për:

v) kontrollin e respektimit të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj;”.

Nderkohë në VKM Nr. 410, datë 13.5.2015 ”Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror teknik dhe industrial”, i ndryshuar, përcaktohet si më poshtë:

”Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të neneve 11 e 51, pika 3, të ligjit nr.10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 1, të nenit 23, të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve

të tyre”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr.8734, datë 1.2.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KRIJIMI I INSPEKTORATIT SHETETË-ROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL

1. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (në vijim ISHTI) është institucioni qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe industrinë (në vijim ministria) me kompetenca inspektimi.”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofron produktin me cilësi duke respektuar standartet Ligjore. Vërtetim i lëshuar nga ky institucion siguron Autoritetin Kontraktor që ofrohet furnizim me karburant cilësor si dhe operatori ekonomik ofertues zbaton kushtet e parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.

Ky kriter është vendosur për të siguruar Autoritetin Kontraktor që Operatori Ekonomik për periudhën e kërkuar ka ushtruar aktivitetin konform ligjeve dhe rregullave që ato përcaktojnë për tregtimin e karburanteve, në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë/raport analizë të lëshuar nga një laborator i çertifikuar në Republikën e Shqipërisë. Fletë/raport analiza duhet të jetë lëshuar jo më parë se 60 ditë nga data e hapjes së procedurës së prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.....

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit “Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 6, gërma “c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofertojnë mallra të cilët përmbushin standartet teknike dhe autoriteti kontraktor kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara.

Ky kriter është vendosur me qëllim konfirmimin e standardeve të përcaktuara në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”.

2.3.6. Për furnizimin e impianteve të ngrohjes kaldajave, Operatori Ekonomik duhet të disponoj në pronësi të vet ose me qira të paktën 2 (dy) mjete autobot. Për arsye të vendodhjes së depozitave të autoritetit kontraktor dhe vështirësisë në rastet e furnizimit autobotet duhet të kenë kapacitet apo vëllim jo më të madh se 1000 (njëmijë) litra.

-Për të provuar disponimin e tyre (në pronësi) shoqëria duhet të dorëzojë librezën e qarkullimit, Çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, Çertifikatën për transportin e mallrave të rrezikshëm, Pasaportën e autobotit, Çertifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe Çertifikatën e verifikimit të kontaltrit të lëshuar nga DPM. Autobotet duhet të jenë të rregjistruar në Ekstraktin e Q.K.R-së së Operatorit Ekonomik.

-Për mjetet e siguruar me qera Operatori Ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën e pronësisë të mjetit, librezën e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, të vlefshme, ku duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi Certificate per transportin e mallrave të rrezikshem, Pasaporten e autobotit, Certificate e mbrojtjes nga zjarri dhe certificate e verifikimit të kontaltrit të lëshuar nga DPM. Autobotet duhet të jene të rregjistruar ne Ekstraktin e Q.K.R-se se Operatorit Ekonomik.

Shënim: Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike,

si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 5/ç ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të disponojë burimin e nevojshëm teknik dhe konkretisht një automjet të përshtatshëm për realizimin e kontratës, pasi nga ana jonë duke patur parasysh se natyrën e furnizimit e cila bëhet sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, ku përfshihet furnizimi i kaldajave në 4 (katër) konviktet në administrim nga të cilat 2 (dy) ndodhen brenda unazës së vogël të qytetit të Tiranës, 1 (një) konvikt jashtë unazës së vogël tek Pallati me Shigjeta dhe 1 (një) konvikt ndodhet në Kamëz vlerësuam se referuar vendodhjes së konvikteve dhe duke patur parasysh trafikun që ka qyteti i Tiranës dhe meqënëse furnizimi bëhet gjatë orarit zyrtar, kërkesa që ofertuesi të disponojë 2 (dy) automjete për furnizimin e kaldajave është mëse i mjaftueshëm.

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohej që operatorët ekonomikë ofertues të kenë në dispozicion os t’u vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për furnizimin e mallrave objekt prokurimi, pra tek mjetet dhe pajisjet përfshihet dhe automjeti i nevojshëm për kryerjen e furnizimit i cili referuar dhe llojit të produktit objekt prokurimi, i cili është karburant gjykojmë se automjetet e kërkuara duhet të jenë të llojit ”Autobot” edhe referuakapacitetit mbajtës së kaldajave prej 3000-5000 litra dhe vendodhjes së tyre dhe hapësirës së vogël të territorit ku ndodhen kaldajat gjykohej se kapaciteti mbajtës i këtyre mjeteve duhet të jetë 1000 litra.

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit ”mallra” duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të automjetetit për transportin e karburantit, por pa përcaktuar se si disponohen këto automjete dhe meqënëse këto mjete qarkullojnë në

territorin shqiptar, ju referuam nenit 81, 83 e 178 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 81

Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik.
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin:
 - a) dhënien me qira pa drejtues mjete;
 - b) dhënien me qira me drejtues mjete dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
 - c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
 - d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të tretëve;
 - e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
 - f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të tretëve.

Neni 83

Dhënia me qira pa drejtues mjete

1. Për zbatimin e këtij neni, një mjet quhet i caktuar për dhënie me qira pa drejtues mjete kur qiradhënësi, kundrejt pagesës, detyrohet të verë në dispozicion të qiramarrësit, me kërkesën e këtij të fundit, vetë mjetin.
2. Mund të caktohen për dhënie me qira të gjitha mjetet me motor dhe rimorkiot e tyre, përfshirë edhe mjetet e caktuara për transportin e mallrave, me ngarkesë të plotë, e cila është mbi 1,5 ton, si dhe mjetet, të ndryshme nga autoveturat, të caktuara për transportin e njerëzve.

Neni 178

Dokumentacioni i nevojshëm për qarkullim dhe drejtim

1. Për të qarkulluar me mjete me motor, drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete këto dokumente:
 - a) lejeqarkullimin;
 - b) lejedrejtimi të vlefshëm për kategorinë përkatëse të mjetit;
 - c) autorizimin për ushtrimin e drejtimit të mjetit që i korrespondon kategorisë së mjetit për të cilin ushtrohet, sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si dhe një dokument identifikimi;
 - ç) dokumentin që vërteton kontrollin teknik për mjetet e transportit rrugor;
 - d) certifikatën e sigurimit të detyruar.

Referuar dispozitave të mësipërme përcaktuam se mjetet mund të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues ose me kontratë qeraje, ku në rastin e pronësisë mbi mjetin të paraqitet, leja e qarkullimit të mjetit, certifikata e kontrollit teknik të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës, certifikata e sigurimit të detyruar (TPL) të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës, ndërsa në rastet kur automjeti është me qera të paraqitet kontrata e qerave dhe dokumentacioni i mjetit në emër të qiradhënësit si ne vijim: leja e qarkullimit të mjetit në emër të qiradhënësit, certifikata e kontrollit teknik të mjetit e vlefshme në momentin e

ofertës në emër të qeradhënësit, cetifikata e sigurimit të detyruar (TPL) të mjetit e vlefshme në momentin e ofertës në emër të qeradhënësit.

Gjithashtu në nenin 23 të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar përcaktohet se:

"1. Organi shtetëror, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë, të ushtruar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është Inspektorati Shtetëror Përgjegjës, që funksionon dhe varet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet. Ky inspektorat mbështetet në kryerjen e funksioneve të tij nga laboratorë të akredituar për fushën dhe testet përkatëse. Këta laboratorë mund të jenë pjesë e këtij inspektorati ose jashtë tij. Për çdo rast testimi, duhet të ruhet fshehtësia e mostrës.

2.a) Inspektorati shtetëror përgjegjës ka të drejtë dhe përgjigjet për:

i) kontrollin e zbatimit të normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ii) miratimin e kartave teknologjike të impianteve dhe instalimeve përkatëse;

iii) kontrollin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në licencat përkatëse, që u janë dhënë personave juridikë, përfshirë edhe kushtet teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe ruajtjen e mjedisit;

iv) garantimin e së drejtës për informim të publikut dhe/ose subjekteve të interesuara mbi rezultatet e analizave të kontrollit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare". Rregullat për dhënien e informacionit për publikun dhe/ose subjektet e interesuara, miratohen nga ministri përgjegjës për hidrokarburet;

v) kontrollin e respektimit të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj;

vi) kryerjen e analizave në laboratorët e akredituar, sipas përcaktimit të pikës 1, për sasinë e naftës e nënprodukteve të saj të prodhuara në vend, të importuara, para zhdoganimit, si dhe për kontrollin periodik të detyrueshëm të subjekteve që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

vii) kontrollin e cilësisë së nënprodukteve të naftës te konsumatorët e mëdhenj.

Shpenzimet për kontrollin e cilësisë së naftës e nënprodukteve të saj përballohen nga vetë subjektet:

- për rastin e futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë;

- për rastin e kontrollit të cilësisë për sasinë e prodhuara në vend;

- për rastin e kontrolleve periodike të detyrueshme;

- për rastin kur rezultojnë shkelje në treguesit e cilësisë.

Tarifat e kontrolleve dhe afatet e kontrolleve periodike përcaktohen nga ministri përgjegjës për hidrokarburet. Në rastet e tjera zbatohen rregullat e parashikuara në ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

b) Për realizimin e këtyre detyrave Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre bashkëpunon me organet e tjera shtetërore dhe të qeverisjes vendore, që mbulojnë fushën e ndërtimit, të rendit publik, të veprimtarisë tregtare, të mbrojtjes nga zjarri dhe të ruajtjes së mjedisit;

c) (E shfuqizuar).

3. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin."

Në Urdhrin e Minisrit të Energjisë dhe Industrisë Nr. 315, datë 28.04.2017 “Procedura e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj” përcaktohet si më poshtë:

“I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.

1. Vërtetimi Teknik lëshohet për:

1. respektimin e normave dhe të kushteve teknike në instalimet teknologjike (terminale detare dhe hekurudhore, depozita, magazina për vajra lubrifikantë, stacione karburanti, njësi të lëndës djegëse)
2. miratimin e Kartës Teknologjike
3. miratimin e projektit teknologjik
4. miratimin e skemës teknologjike

për të gjitha subjektet, objekt i ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin ,transportimin, tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar dhe ligjit Nr. 9876, datë 14.02.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lendeve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”, i ndryshuar dhe jepet nga Organi i miratuar i vlerësimit të konformitetit (OMVK), i pajisur me aktin e posaçëm të miratimit për ushtrimin e këtij aktiviteti. OMVK duhet të disponojë stafin e nevojshëm të kualifikuar me eksperiencë jo me pak se pëse vjet në fushën e këtyre instalimeve, dhe të ketë edhe staf e pajisur me lejen profesionale në përputhje me dispozitat e VKM 551/2015.

2. Formati tip i Vërtetimit Teknik përmban, por pa u kufizuar:

- Emrin e subjektit.
- Llojin e Veprimtarisë.
- Vendndodhjen e instalimit, projektin teknik e teknologjik të tij, si dhe normat, kushtet dhe rregullat teknike të zbatueshme për këtë instalim.
- Kategorinë e produkteve dhe markën që prodhohen apo depozitohen.
- Kapacitetin prodhues apo depozitues.
- Afatin e Vlefshmërisë të tij.

II. Procedura dhe dokumentacioni.

A. Për tu pajisur me Vërtetim Teknik, për herë të parë, subjekti paraqet pranë Organit të miratuar të vlerësimit të konformitetit në përputhje me piken 1 të kreut 11 të VKM 491 date 19.07.2017, kërkesën të shoqëruar me këto dokumente.”.

Në nenin 41, pika 1 dhe 4 të Ligjit nr. 152, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” përcaktohet se:

“1. Shërbimi vendor i MZSH-së miraton projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin që shoqëron dokumentacionin tekniko-ligjor të lejeve zhvillimore, lejeve të ndërtimit, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2. Shërbimi qendror i MZSH-së miraton projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin që shoqëron dokumentacionin tekniko-ligjor të lejeve të zhvillimit dhe të ndërtimit të objekteve me rëndësi ekonomiko-strategjike kombëtare, dhe të objekteve me rrezikshmëri të theksuar për zjarr e

shpërthim, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

3. Klasifikimi i objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e miratimit, koha dhe mënyra e shqyrtimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, që shoqërojnë dokumentacionin tekniko-ligjor, lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit, si dhe e lëshimit të certifikatës të mbrojtjes nga zjarri, miratohen me udhëzim të ministrit.

4. Personi i ngarkuar nga shërbimi i MZSH-së për miratimin e dokumentacionit teknik që shoqëron lejet zhvillimore/ndërtimore, si dhe për dokumentacionin për lëshimin e certifikatës së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, mban përgjegjësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

Në pikën 6 të VKM Nr.1047, datë 16.7.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.170, datë 25.4.2002 të këshillit të ministrave “për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve, për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar” përcaktohet se:

“6. Pas pikës 6 të kreut IV, shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“7. Shoqëritë e pajisura me leje tregtimi ose autorizim, brenda 30 ditëve nga data e pajisjes, duhet të kryejnë sigurimin e përgjegjësisë ligjore për dëmet, që mund t’u shkaktohen palëve të treta, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë.

Shoqëritë, që kanë kryer sigurimin e përgjegjësisë ligjore për dëmet, që mund t’u shkaktojnë palëve të treta, sipas përcaktimit të shkronjës “a”, duhet që brenda këtij afati, të paraqesin dokumentin përkatës në organin, që ka lëshuar lejen e tregtimit ose autorizimin.

Shoqëria nuk do ta ushtrojë veprimtarinë deri në çastin e paraqitjes së këtij dokumenti në organin, që ka lëshuar lejen e tregtimit ose autorizimin.”.

1- Perse karburanti konsiderohet “mall i rrezikshem”

Ne baze te Ligjit nr. 9272, date 16.9.2004 “Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne marreveshjen europiane “Per transportin nderkombetar rrugor te mallrave te rrezikshme (ADR)” “Mallra te rrezikshme” jane ato substanca ose artikuj, transporti me rruge ose me hekurudhe i te cileve eshte i ndaluar ose i autorizuar vetem ne rrethana te caktuara nga ADR-ja ose RID-i nga Aneksat A dhe B te **Marreveshjes Europiane per Transportin Nderkombetar Rrugor te Mallrave te Rrezikshme, ADR-se dhe klasifikimit te tyre.**

Mallrat e rrezikshme jane ato lende te cilat gjate prodhimit, transportit dhe manipulimit mund te jene te rrezikshme dhe te demshme, qe kane pasoja si ne aspektin shendetesor te personave te perfshire gjate transportit dhe me gjere, dhe demeve materiale qe jane te permasave te paparashikueshme.

Pra termi “mall i rrezikshem” per karburantin i perket klasave te mallrave te rrezikshme sipas ADR-se(dhe jane 7 klasa) karburant eshte nafta,gazi benzina.

2- Transporti i karburanti perse autoboti kerkon certifikate ADR?

“Certifikate e miratimit te mjetit, sipas ADR-se” eshte certifikata e miratimit te mjetit, sipas nenit 37 pika 1 te ligjiit Nr. 118/2012 Per Transportin e Mallrave Te Rrezikshme, qe verteton se nje mjet i vetem i destinuar per transportin e disa mallrave te rrezikshme ploteson kerkesat teknike perkatese, sipas marreveshjes se permendur ne piken 1 te nenit 5 te ketij ligji.

3- Transporti i karburantit perse autoboti kerkon certifikate te mbrojtjes nga zjarri

Per kete pike nuk eshte se kam nje informacion por mbase ligji 152 /2015 Për Shërbimin E Mbrojtjes Nga Zjarri Dhe Shpëtimin mund te jete reference., ose duhet te pyesesh ndonje qe eshte ne kete insitucion qe leshon certifikata te tilla.

4- Transporti i karburantit perse autoboti kerkohet qe te jete i pajisur me pashaporte kapaciteti mbajtes

Ne baze ligjit Nr. 126-2020 date 15.10.2020 ‘Per metrologjine’ neni 20 pika a,b,c,ç,d, neni 22 pika 1 dhe 3

Sipas ligjit, dhe standarteve, autobotet konkretisht cisterna qe mban lenden e rrezikshme jo i gjithë mjeti, quhen **instrumenta matese ligjerisht te kontrolluara.**

Termi “pasaporte” sipas ligjit e standarteve nuk ekziston, ajo qe shoqeron cisternen pas verifikimit eshte “**Certifikata e verifikimit te vellimit te cisternes**” Pasaporta eshte nje dokument shtese qe shoqeron Certifikaten por ka mbetur si dok kur kete sherbim e ofronte Drejtoria e Metrologjise.

4- Transporti i karburantit perse autoboti kerkoket qe te jete i pajisur me certifikate kolaudimi te kontolitrit

[VKM nr. 770, datë 2.11.2016 ‘Për miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet matëse”, për disa ndryshime në vendimin nr.1351, datë 3.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kërkesat dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara”, dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara’](#)

Ankesi VII Sistemet e matjes per matjen e vazhdueshme dhe dinamike te saisve te lengjeve pervec ujit.

2.3.7. Bazuar në VKM Nr.561 date 29.07.2016 ”Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” OE pjesëmarrës duhet të ofrojë një faqe menaxhimi (webpage) ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për kaldaja të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.

- Faqja e menaxhimit (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga OE drejt AK, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuara si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vetë AK.

-Faqja e menaxhimit të karburanteve duhet të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të AK, shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike të cilat ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë kaldaje.

- Operatorët ekonomikë pjesmarres duhet të paraqesin një deklaratë se Disponojne/ekzistencën e faqes së menaxhimit së bashku me ofrimin e shërbimeve të kërkuara me siper.

-Malli/karburanti do te ofrohet me karta elektronike të personalizuara për karburantin për kaldaja do të bëhet me autobot sipas nevojës të Autoritetit Kontraktor. Autoriteti kontraktor ka të drejte të kerkoje furnizim sa here të kete të nevojshme duke e realizuar kete kerkese me shkrim ne menyre zyrtare.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe në përcaktimet e bëra në VKM nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Për këtë qëllim është kërkuar që të paraqitet një deklaratë e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët duhet të ofrojnë furnizimin me karburant nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, gjë e cila garanton Autoritetin Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës, sipas kuadrit rregullator të përcaktuar në VKM nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Nëpërmjet këtij kriteri synohet gjithashtu, edhe evitimi i kostove të shtuara për Autoritetin Kontraktor, sa i përket kostos së prodhimit dhe pajisjes me karta elektronike të personalizuar, në funksion të zbatimit të kontratës.

2.3.8. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike, të personalizuar në lëng me bot sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Kartat elektronike duhet të jenë të vlefshme dhe për Vitin 2024, pa afat skadence deri në përfundimin e plotë të kontratës. Subjekti ofertues duhet të marrë përsipër furnizimin me botet e tij dhe shpenzimet e tij në shërbim 24 orësh në vendodhjen e Autoritetit Kontraktor.(Deklarate nga administratori i subjektit ofertues)

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Nëpërmjet vendosjes së këtij kriteri, synohet që Operatorët Ekonomikë ofertues të dëshmojnë disponibilitetin e nevojshëm për furnizimin e pandërprerë me karburant nëpërmjet paraqitjes së deklaratës së kërkuar, gjë e cila garanton Autoritetin Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.9. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se furnizimi do të jete e mundur të realizohet cdo dite të javës brenda 24 orëve në vendodhjen e Autoritetit Kontraktor i cili ka të drejtë të kërkojë furnizim sa here e ka të nevojshme.(Deklarate nga administratori i subjektit ofertues),

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me

sukses të kontratës”. Nëpërmjet vendosjes së këtij kriteri, synohet që Operatorët Ekonomikë ofertues të dëshmojnë disponibilitetin e nevojshëm për furnizimin e pandërprerë me karburant nëpërmjet paraqitjes së deklaratës së kërkuar, gjë e cila garanton Autoritetin Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Gazoil (Diesel 10 ppm ULSD), për kalidaja sipas standardit: S SH EN 590:2022

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë elementet më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike të Gazolit (Diesel 10ppm ULSD)

Gazoil (Diesel 10 ppm ULSD sipas standardit: S SH EN 590:2022

Lëndë djegëse Gasoil (Diesel 10ppm ULSD)

Argumentim:

Hartimi i specifikimeve teknike të Gazoilit (Diesel 10 ppm ULSD) është bërë në përputhje me Standardet Shtetërore në fuqi të publikuara aktualisht në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve, Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, I ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzene dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nën produkteve të saj”.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Furnizimi do të realizohet në distributor nëpërmjet kartave elektronike ose me autoboot pranë konvikteve. Kostoja për pajisjen me karta elektronike duhet të përballohet nga kontraktuesi.

Operatori ekonomik fitues bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”,

Kartat elektronike duhet të jenë të vlefshme dhe të përdorshme deri në ekzekutimin e plotë të vlerës së përgjithshme të kontratës.

Kontraktuesi duhet të marrë përsipër ofrimin e furnizimit me karburant 24 orë në çdo ditë të javës. Furnizimi me karburant do të bëhet sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.

Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.